Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**28.02.2024**	**11.03.2024**	**2024/0156**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.02.2024, **OE "AAG PROJEKT"- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0156,** kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **O.E Grup i Operatorëve Ekonomik DAJTING SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P.K.,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi i objektit te ri te Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER"** me nr. të prokurimit: **"635-23-10843-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KOMUNA E PEJES**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **3,070,665.98 Euro per Vitin 2023,2024,2025**.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1032 i dt:23.01.2024.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji për Prokurim Publik i konsoliduar

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit;

Neni 25.8 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës ;

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional;

Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik;

Neni 105 – Kompetencat e OSHP-se

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Neni 131 Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues.

Rregullorja nr. 001/2022, per Prokurim Publik

Neni 16 – Regjistri permbledhes i Prokurimit,

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 97 Shkeljet e Renda

Udhëzuesi për Prokurim publik 001/2023.

Neni 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

Te nderuar,

Me datën 09/02/2024, Autoriteti Kontraktues – Komuna Peje, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues se bashku me letrat standarde ku eshte ri-rekomanduar për dhënie te kontratës grupi i operatoreve ekonomik "Dajing" Sh.P.K. & "NNP ATC COM" Sh.P.K, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit "Ndërtimi i objektit te ri te gjimnazit shkencor Bedri Pejani" me nr. te prokurimit: 635-23-10843-5-1-1, përkundër faktit se me vendim te OSHP-se, është konstatuar se te nejtit kane ofertuar si te papergjegjshme.

Pretendimi ankimore 1:

Grupi i OE-ve ankues, me datën 13.02.2024, ka parashtruar kerkese për ri shqyrtim te vendimit te AK-se, propozimit për dhënie te kontratës dhe ri rekomandimit për kontratë te grupit te OE-ve, te cilet Organi Shqyrtues i Prokurimit – Paneli Shqyrtues, me vendim i ka kualifikuar si te pa pergjegjeshem.

Sipas vendimit te AK-se te datës 15.02.2024, është refuzuar kerkesa jone si e pa bazuar përkundër faktit se ne si OE, kemi prezantuar fakte dhe dëshmi konkrete ku vertetohet se janë prezantuar dokumente fiktive ne oferte.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Peje, fare nuk i trajton pretendimet dhe kerkesat tona madje te njejtat i manipulon dhe inkriminohet ne veprime penale, te sanksionuara me Kod Penal te

Republikes se Kosovës, rrjedhimisht shkele dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se, paragrafin 8 pika 4. "autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi".

Autoriteti Kontraktues – Komuna Peje, zyrtaret përgjegjës te Prokurimit perfshire edhe anëtaret e komisionit vleresues te ofertave nuk i kane shqyrtuar, pretendimet ankimore ne kuptim te asaj qe ne si OE kemi kerkuar.

Ne ne kekrese për ri shqyrtim kemi prezantuar prova shkresore dhe dëshmi ku rezulton qe është nderhyr fizikisht ne dokumente siç janë certifikimet e prezantuara ne oferte ne emer te z. Arben Murseli, dhe numrat e certifikatave tregojne për persona tjerë dhe jo për atë qe është ofruar ne oferte. Përkundër këtyre fakteve AK – Komuna Peje sipas, vendimit te datës 15.02.2024, mohon dhe prezanton prova tjera, përkatësisht nderyhun fizikisht dhe manipulon me dokumente te cilat janë prezantuar ne oferte dokuemente këto te cilat do ti argumentojme ne pretendimet ankimore vijuese.

Pretendimi ankimor 2:

Autoriteti Kontraktues - Komuna Peje, përkatësisht, Zyra e Prokurimit se bashku me anëtaret e komisionit ri-vleresues te ofertave, përmes këtij publikimi perseri kane konsumuar shkelje ligjore te dispozitave te LPP-se nr. 04/L-042 te amandamentuar, madje kane shkelur edhe vete vendimin e Organit Shqyrtues te Prokurimit me nr. 1032/23 te datës 23/01/2024, te nxjerre pikerisht për këtë procedur te prokurimit.

Bazuar ne ankesen tone te dt. 19/12/2023, te parashtruar, paraprakisht ne OSHP, eksperti shqyrtues me dt. 05/01/2024, ka nxjerre raport dhe pretendimet tona ankimore i ka kualifikuar si te bazuara, madje ne te njejtin raport është konstatuar se grupi i OE-ve te cilet AK, e ka ri-rekomanduar për dhënie te kontratës, ka dorezuar oferte te papergjegjshme dhe atë lidhur me

- stafin e kualifikuar - Menaxherin e Projektit,

- Menaxherin e Punishtes,

- Lidhur me deklaratat për krijim te grupit te te njejteve OE,

- Lidhur me stafin mbeshtetes, përkatësisht:

- Certifikimet e tyre si dhe me

- Pajisjet teknike te aplikuara për këtë procedure te prokurimit.

Prove: Raporti e Ekspertes Shqyrtuese i dates 05.11.2024, me nr. 1032/2023.

Përkundër këtij fakti, AK dhe Zyra pergjegjese e prokurimit, është pajtuar se grupi i OE-ve, te cilet perseri jane rekomanduar për dhënie, kane dorezuar oferte te papergjegjshme, rrjedhimisht paneli shqyrtues i OSHP-se ka nxjerre vendim dhe AK – Komuna Peje, eshte obliguar qe pergjate procesit te rivleresimit te ofertave t'i respektoni ne perpikmeri te gjeturat e ekspertit shqyrtues.

Për këto veprime kundërligjore, AK – Zyra e Prokurimit si dhe anëtaret e komisionit rivleresues vec e vec, jeni përgjegjës për mos respektim te vendimit te OSHP-se ashtu

siç percaktohet me nenin 97, pika d) dhe h) ku percaktohet:

d) Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të percaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë, vendosjen e kritereve apo dëshmive jo në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabart të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njësisë së kërkesës.

h) Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së

Prove: Vendimi i Panelit Shqyrtues i datës 23.01.2024, me nr 1032/2023

Pretendimi ankimor 3:

Sipas qasjes se kerkuar dhe te ofruar ne dokumentacion, përkatësisht sipas pergjigjes se dhënë nga grupi i OE-ve ndaj kerkeses për sqarim ku AK – Komuna Peje është bazuar ne te njejtat sqarime dhe ka ri rekomanduar për dhënie te kontratës grupin e OE-ve "Dajting & ATC Com" shpk, rezulton qe jo për te gjitha te gjeturat e eksperit është kerkuar sqarim dhe plotesim.

Ne si OE ankues edhe ne ankesen paraprake por edhe ne kerkese për ri shqyrtim e kemi prezantuar bazen ligjore dhe faktet tjera se nuk është kerkuar sqarim shtes për te gjitha pretendimet tona dhe te gjeturat ne ekspertize.

- AK- Komuna Peje, ofertën e grupit te OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës, detyrimisht ka qene dashur ta eliminoni si te papergjegjshme, madje ta njoftoni organin shqyrtues te prokurimit, ne kuptim te nenit 99.2 te LPP-se dhe te kerkoni qe grupin e OE-ve te cilet perseri eshte rekomanduar për dhënie te kontratës, te diskualifikohen nga procedurat e prokurimit, pasice te njejtit ne ofertën e tyre kane dorezuar dokumente fiktive, mashtruese dhe te falsifikuara.

Grupi i OE-ve, te cilet perseri kunderligjeshem jane rekomanduar për dhënie te kontratës, ne oferte kane prezantuar deklarate nen betim ku përmes te njejtes kane marre përgjegjësi penale, civile dhe te njejtit vec e vec janë betuar se te gjithë dokumentacioni i dorezuar ne oferte është real.

Tani ne sqarimin e ofruar te njejtit OE vec e vec "Dajting"shpk dhe "ATC COM" Sh.P.K, vet e pranojne se ne oferte te tyre kane prezantuar dokumente fiktive dhe se ne shkresen e njejte, potencojne se kur te lidhet kontrata do t'a ndryshojne gjendjen e menaxherit te projektit dhe te menaxherit te punishtes, përkatësisht do ta ndryshojne gjendjen nga punetor jo te rregullt ne punetor te rregullt.

AK – Komuna Peje, këto pohime detyrimisht ka qene dashur t'i raportoni ne OSHP, dhe te kerkoj qe te veprohet ne kuptim te nenit 99.2 te LPP-se, ndaj te dy OE-ve vec e vec, mece te njejtit vet e konfirmojne se ne oferte kane prezantuar kontrata fiktive ku ne to pershkruhet se menaxheri i projektit dhe ai i punishtes janë te punesuar ne kompani perkatese me orar te plote dhe atë nga ora 8 deri ne 16.

Grupi i OE-ve ne ofertën e tyre kane prezantuar deklarata tatimore, kane prezantuar listën e stafit te ATK-se dhe ndaj te inxhinierëve potencohet se te njejtit ne kompanite perkatese nuk janë te punesuar te rregullt.

Dajting Shpk & ATC Com shpk, si menaxher te projektit kane prezantuar z. Fisnik Syla

- Ne oferte eshtë prezantuar kontrata e datës 10.11.2015, e lidhur me punëdhënësin "Dajting"shpk, me orar prej 40 orë ne jave, kurse ne Listën e Punëtoreve (ATK) ne emër te anëtarit "Dajting"shpk, z. Sylaj, rezulton qe punën e ka sekondare tek OE "Dajting"shpk dhe jo si punëtor primare siç potencohet ne kontrate.

Sipas kësaj, rezulton qe janë prezantuar dokumente jo reale apo edhe fiktive përmes te cilave nuk është prezantuar gjendja reale, pasi qe menaxheri i projektit është e pa mundur qe te jete ne marrëdhënie pune ne dy lokacione te ndryshme përgjatë kohës se njëjtë.

- Prove lista se ATK-se e cila është e ngarkuar ne sistem dhe te verifikoni një gjë te tille si dhe ueb faqes se ATK-se, përmes numrave personal.

Ngjashëm është vepruar edhe me menaxherin e punishtes ku është prezantuar z. Skender Loshi. Ne kontratën e lidhur me datën 03.01.2020, ne nenin 4, përcakton se orari i punës me punëdhënësin – anëtarin e grupit "ATC Com" shpk eshtë përcaktuar orari i punës prej 40 ore ne jave apo nga ora 08 deri ne 16. Sipas listës se Punëtoreve te ATK-se, te prezantuar ne oferte, z. Loshi, rezulton te ketë pune sekondare me anëtarin e grupit ATC Com shpk. Pra edhe z. Loshi me punë primare është i deklaruar ne institucion tjetër ne cilësi te mësimdhënësit ne Shkolle te mesme dhe jo me anëtarin e grupit ATC Com shpk, prandaj edhe kontrata e prezantuar ne oferte e lidhur me z. Loshin do duhej te konsiderohej si fiktive dhe jo reale dhe si e tille krijon alibi, meçe është e pa mundur qe një person te jete i kontraktuar me pune primare ne dy vende pune apo ne dy lokacione te ndryshme.

- Prove mund ti referoheni ueb faqes se ATK-se dhe rezulton qe i njëjti si punë primare ka institucion tjetër, ngjashëm verifikimi mund te behet përmes numrit personal i prezantuar ne oferte.

Prova – Fisnik Sylaj – Menaxheri i Projektit.

KONTRATË PUNE

E nënshkruar me datë 10 Nendor 2015 në mes të:

Sh.p.k. DAJTING, nga Prishtina Lagja Kalabria Objekti Dardha H-1/22, e regjistruar me NRB : 70883767, Nr. Fiskal: 600863270, (më tej e refuaruar si 'Punëdhënësi')

dhe

Fisnik Ukë Sylaj, me vendbanim në Kodrali, Deçan/Kosovë, dhe me numër personal 1004547493 (më tej e referuar si 'I punësuar')

Së bashku referohen si 'Palët kontraktuese'.

Neni 5

1. I punësuari është I punësuar me orar të plotë.
2. Orari plotë gjatë javës është 40 orë.
3. Dita e rregullt e punës gjatë javës fillon të Hënën dhe mbaron të Premten duke filluar në orën 8:30 deri në orën 16:30.
4. Cdo ndryshim në orar sipas Paragrafit 3 të këtij neni duhet ti komunikohet të punësuarit së paku një javë më parë.
5. I punësuari ka të drejtë 30 minuta pushim në ditë me pagesë gjatë orarit të punës.
6. I punësuari ka të drejtë të pushimit gjatë orëve jashtë orarit të punës dhe gjatë vikendit (Të

Prova – Skender Loshi – Menaxheri i Punishtes

KONTRATË E PUNËS

E lidhur në Kaqanik, në mes të:

1. PUNËDHËNSI : "ATC COM SHPK" me seli ne DOGANAJ ,KAQANIK me Nr.të Biznesit 810198780, , në cilësinë e Punëdhënësit (Në tekstin e mëtejmë: Punëdhënësi), në një anë dhe

2. I PUNËSUARI : Skender Loshi, lindur ne Vraniq-Suhareke, me: **06.06.1979**, me vendbanim në **Prishtine.**

Neni 1

VENDI I PUNËS:Punëtori themelon marrëdhënien e punës në vendin e punës (Punët dhe detyrat e punës):**Ingjinjer i Ndertimtarise-Konstruktiv.**

Neni 2

Marrëdhënia e punës themelohet me kohë të pacaktuar ashtu që të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit nga marrëdhënia e punës punëtori i realizon nga dita e fillimit të punës.

Neni 3

KOHË ZGJATJA E KONTRATËS: Marrëdhënia e punës nga neni 2 fillon prej dates 03.01.2020 , dhe përfundon me pelqimin e dya paleve nese eshte e nevojshme .

Neni 4

ORARI I PUNËS DHE PUSHIMET: Orari i punës së punëtorit zgjatë **40 Orë pune** në javë, ne base te specifikave dhe obligimeve qe lindin nga kompania , mirpo mund edhe mos te punon nese kompania nuk ka kontrata aktive.

*Punëtori gjatë orarit të punës ka të drejtë në pushim prej 1 ore për ushqim i cili shfrytëzohet nga punëtori në kohën kur përcaktohet se nuk e dëmton procesin normal të punës.

Pra grupi i OE-ve te cilët AK – Komuna Peje, ka rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar kontrata dhe prova fiktive te cilat nuk korrespondojnë me gjendjen reale, rrjedhimisht oferta e tyre ka qene dashur te eliminohet si e pa përgjegjshme dhe ne kuptim te nenit 7 dhe 59, te LPP-se, komisioni i vlerësimit te ofertave se bashku me zyrtarin përgjegjës te prokurimit barte përgjegjësi individuale.

Ne nenin 22 te Dosjes se tenderit te pjesa 2 e kontratës (Kushtet e Përgjithshme) përcaktohet:

22.1 AK do te emëroje Menaxherin e Projektit te caktuar ne KVK i cili do te jete përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimi te punëve gjate tere kohës, duke filluar nga dita e pare e fillimit te punëve e deri ne skadimin e periudhës garantuese te defekteve dhe për raportim te AK.

Menaxheri i projektit dhe menaxheri i punishtes sipas nenit 69, paragrafi 4, pika 3, te LPP-se, janë personel udhëheqës teknik dhe janë përgjegjës te drejtpërdrejte ndaj Autoritetit Kontraktues. Ne Republikën e Kosovës, me ligj te Punës dhe me ligjin për sektorin Publik orari i punës fillon ne ora 8 dhe përfundon ne ora 16.

Lidhur me Menaxherin e projektit dhe Menaxherin e Punishtes po ashtu ekzistojnë shume

vendime te nxjerra nga OShP ku qarte përcaktohet se Menaxheri i Projektit dhe Stafi tjetër kyç duhet te jete staf i rregullt i Kontraktuar nga Operatori Ekonomik.

- Ju si AK si prove paraprakisht keni pasur vendimin e OSHP-se me nr. 406/2023 por te njejtin e keni injoruar dhe nuk i jeni referuar.

Për me tepër për këtë qeshtje AK – Komuna Peje përgjatë ri vlerësimit te ofertave ka kerkuar sqarim për këtë qeshtje, ka pranuar sqarime nga grupi i OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës dhe është potencuar se pas nenshkrimit te kontratës do te ndryshohet statusi i menaxherit te projektit dhe atije te punishtes ku nga sekondar do te kalohet ne primar. Ky pohim paraqet ndryshim material dhe thelbesore te ofertës dhe për këtë qeshtje me patjeter AK – Do duhej te eleminonte ofertën e tille por quditerisht inkriminohet edhe me thelle ne shkelje bazike te dispozitave ligjore te LPP-se dhe jo vetëm.

Pretendimi ankimore 4:

Ne pergjigjjen e grupit te OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës, pershkruhet dispozita ligjore e nenit 71.2 te LPP-se, lidhur me krijimin e grupit – konzorciumin, perderisa përmes kerkeses për sqarim AK – Komuna Peje, nga grupi i OE-ve te njejte, nuk ka kërkuar fare sqarim shtese lidhur me krijimin e grupit ku eksperti shqyrtues përmes raportit te ekspertizes, përkatësisht paneli shqyrtues përmes vendimit ka konstatuar se janë prezantuar deklarata për krijimin e grupit – konzorciumit ne mënyre te kundërligjshme, perkatesisht dy deklarata te ndryshme – variante dhe nuk dihet se cili nga dy anëtaret e grupit është lider. Ne njërën ane si lideri i grupit eshtë caktuar OE "Dajting" shpk, ne anën tjetër OE "ATC Com shpk.

- Deklarata e tille nuk i plotëson kushtet ligjore te nenit 71, te LPP-se dhe nenit 26, par. 1, pika a,b,c dhe d, te RRPP-se, nr. 001/2022 dhe AK, detyrimisht ka qene i obliguar ta eliminoi te njëjtën oferte si te pa përgjegjshme pasi qe:

Neni 10 i Udhëzuesit nr. 001/2023, sqarimi i tenderit gjate procesit te vlerësimit sqaron rastet kur dhe si AK mund te kërkojë plotësim te dokumentacionit:

- Nëse mungon deklarata e qarte ku te gjithë e anëtaret e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës, tenderi duhet te refuzohet pasi qe ky është kusht administrativ.

Prove: deklarata:

D E K L A R A T Ë

Në mes të:

1. **"DAJTING"SH.P.K.** me Çertifikatë të Regjistrimit Nr: **810820086** e përfaqësuar nga z. **Fisnik Sylaj**, Drejtor .
2. **"ATC COM"SH.P.K.** me Çertifikatë të Regjistrimit Nr: **811198780** e përfaqësuar nga z. **Arben Murseli**, Drejtor .

Ne poshtë të nënshkruarit si përfaqësues të grupit-konzorciumit për tenderin:

Titulli : **Ndertimi i objektit te ri te Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER**

Nr. Prokurimi: **635-23-10843-5-1-1**

Palët janë pajtuar që bartës i projektit të jetë partneri udhëheqës **"ATC COM "SH.P.K.** i cili autorizohet që të firmosë të gjitha dokumentet e nevojshme në lidhje me tenderin dhe kontratën.

Palet e marreveshjes:

"ATC COM "SHPK
Arben Murseli

"DAJTING" SHPK
Fisnik Sylaj

AK – Komuna Peje, zyra e Prokurimit, me rastin e plotësimit te te njëjtës deklarate përgjatë procesit te vlerësimit te ofertave ka shkelur dispozitat ligjore, siç është nenit 7 dhe 59.2 i LPP-se, përkatësisht nenit 10 te Udhëzuesit për Prokurim publik, pasi qe ka munguar deklarata e qarte e grupit dhe ka pranuar plotesim te dokumentacionit i cili nuk ka ekzistuar me rastin e ofertimit, përkatësisht oferta e grupit te ri rekomanduar për kontrate ka pesuar ndryshim material, ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se.

AK – Komuna Peje, fare mire eshte ne dijeni për deklarata te tilla ku është konstatuar gjendja reale dhe përmes procesit te rivleresimit te ofertave por quditerisht është anashkaluar ky fakt.

Pretendimi ankimore 5:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës, nuk kane prezantuar dëshmi lidhur me kërkesën tjetër kualifikuese, ku ne piken 4 te kërkesës 9.1 & 9.2, AK – Komuna Peje, ka kërkuar një person te certifikuar – diplomuar për kulme te rrafshëta.

Sipas pergjigjjes se dhënë nga grupi i OE-ve ndaj kerkeses për sqarim dhe te trajtuar si te mirecene nga AK, shihet qarte se OE-te e ri rekomanduar për dhënie te kontratës janë te papergjegjshem lidhur me certifikimin – diplomimin e personit për kulme te rrafshta ku tentohet perseri te manipulohet me prova shkresore dhe nuk prezantohet kurrfare deshmie lidhur me certifikimin e tille dhe AK ne kundershtim me nenin 59 dhe 72 te LPP-se pranoni dokumentacion shtese te paqene ne oferte dhe pranimi i dokumenteve te tilla pas hapjes se ofertave është i ndaluar sipas LPP-se dhe paraqet ndryshim material te ofertës.

Madje sipas Agjencise Shqiptare te Punesimit – ASHP, përkatësisht bazuar ne ueb faqen e tyre (https://ashp.al/te-gjitha-kurset/), rezulton qe i njejti Agjencion fare nuk certifikon persona tille lidhur me hidroizolimet te ftohta dhe te ngrohta, përkatësisht kulme te rrafsheta. Rrjedhimisht, kjo certifikate eshte fiktive sipas uebfaqes dhe AK bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-se do duhej te kerkonte sqarim dhe ta eleminonte ofertën e tille.

Përkundër kesaje AK – Zyra e Prokurimit, behet pjese e manipulimit me prova shkresore dhe konsumon shkelje bazile te dispozitave ligjore dhe nenligjre, madje veprimet e tilla konsiderohen si shkelje te renda ne LPP, bazuar ne piken b) te nenit 97, te RRPP-se, nr. 001/2022.

AK – Komuna Peje dhe zyrtaret përgjegjës te prokurimit certefikatat e tilla dhe te kontestuara ka qene dashur ti prezantojne tek Agjencioni Shqiptare i Punesimit si organ ku pretendohet se janë nxjerre certifikatat dhe te kerkohej nese i njejti organ i ka nxjerre te njejtat certifikime, përkatësisht certifikaten e preranruar ne emer te z. Liman Murseli është reale.

Pretendimi ankimore 6:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës përkatësisht lideri i grupit OE "Dajting" Shpk, ne shkresa te lendes ka bashkangjitur referencën ne emër te inxhinierit te elektroteknikes z. Hysen Gashi, ku është lëshuar ne cilësi te punëve paraprake te realizuara por i njëjti nuk është i deklaruar si i punësuar tek OE "Dajting"shpk, prandaj kjo reference do duhej te trajtohej si dokument fiktiv – jo real dhe do te duhej te eliminohej si oferte e pa përgjegjshme ligjërisht.

Edhe pas ofrimit te sqarimit lidhur me këtë ceshtje nga grupi i OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës, nuk ofrohet kurrfare deshmie se z. Hysen Gashi, është pjese e stafit te anetarit te grupit, nuk është prezantuar kurrfare kontrate apo dëshmi tjetër dhe si e tille do te duhej te eliminohej si e papergjegjshme oferta e tyre bazuar ne kerkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate, përkatësisht sipas pikës 9.1 dhe 9.2, pozicioni 2.6, dhe deshmise dokumentare ndaj kesaj kerkese, ku qarte është përcaktuar qe: OE duhet te prezantoje dëshmi kontrate valide; parakontrate noteriale me vertetim – nenshkrim te noterit; diplome te noterizuar – certifikate te noterizuar (për inxhinirat qe kerkohet). Certifikata e prezantuar tani pas sqarimeve te ofruara nuk permban noterizim e as nuk është prezantuar kontrate.

Noterizimi i prezantuar ne vendimin e AK-se, kundrejt kerkeses sonë për ri shqyrtim është noterizim për tjetër dokument dhe jo për dokumente te kontesura.

Ngjashëm është vepruar edhe lidhur me inxhinierin z. Rrahman Safedini, ku ne shkresa te lendes nuk është prezantuar ndonjë reference për pune paraprakisht te realizuara, rrjedhimisht

nuk e plotëson kërkesën dhe deshmine e përcaktuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ku ne piken 9.1 dhe 9.2 te FDT-se është kërkuar CV, reference, përkatësisht përvoja e punës sipas periudhës se përcaktuar.

Edhe për z. Rrahman Safedini, nga grupi i OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës, ne pergjigjje ndaj kerkeses për sqarim, vet pershkruhet kerkesa kualifikuese dhe deshmia dokumentare ne njeren ane ku qarte ne dosje te tenderit është kerkuar "një pasqyre tabelare e punetoreve dhe personelit, është kerkuar profesioni i kerkuar si dhe eksperienca duhet te dorezohet ne origjinal, e nenshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik". Ky tekst vet shkruhet nga grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie dhe ne anen tjetër potencohet se nuk është kerkuar CV dhe as reference, prandaj bazuar ne shkresa te lendes dhe dëshmite e preznatuara ndaj te njejtit nuk është prezantuar kurrfare deshmie mbi eksperiencen, mbi profesionin apo dëshmi tjetër përmes te cilave mbulohet kerkesa kualifikuese e përcaktuar ne DT dhe e manipuluar përmes sqarimit – pergjigjjes ndaj kerkeses për sqarimit nr. 4. Ne ofertën e grupit te OE- ve te rekomanduar për dhënie te kontratës. z. Arben Murseli, është prezantuar ne cilësi te drejtorit te anëtarit "ATC Com" shpk, sipas certifikatës se ARBK-se, është nënshkruar deklarata nen Betim, ne emër te tije ne cilësi te Drejtorit te kompanisë, ndërsa tek lista e stafit mbështetës i njëjti është prezantuar ne cilësi te Personit te certifikuar për drenazhim te dheut dhe për trajtim te mbetjeve te rrezikshme inerte, është prezantuar si person i certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune ne cilësi te menaxherit, ndërsa sipas kontratës se datës 01.05.2021, se lidhur me vetveten rezulton qe z. Arben Murseli është i kontraktuar me OE "Atc Com" shpk, me kualifikimet si :Ekonomist, gjeodet, person i certifikuar për armim, drenazhim, mbrojtje inerte dhe menaxher i punishtes.

Këto dëshmi bien ndesh me kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate pasi qe AK- Komuna Peje, për secilën pozitë dhe pozicion ka kërkuar staf veç e veç dhe jo kualifikime gjithë përfshirëse, prandaj AK, detyrimisht ka qen dashur qe te njëjtën oferte ta eliminoj meçe kemi te bëjmë edhe me konflikt te interesit te përcaktuar me nenin 4 te LPP-se.

Për këtë ceshtje OSHP ka nxjerre vendime ku ka konstatuar se për secilen pozite te kerkuar duhet te prezantohet individ – person i vecante.

Si prove mund t'i referoheni vendimit me nr. 628/22.

Për me tepër, argumentimi i deshmive dhe shkresave fiktive – manipulative dhe te falsifikuara konstatohet përmes ueb faqes https://www.wqrcert.com/sorgulama.php, sipas numrit te pershkruar ne certifikate: 20022743 ku pershkruhet se Arben Murseli është i certifikuar për drenazhim te dheut dhe certifikimi i tille ka qene i vlefshem deri me datën 26/02/2021. Për me tepër shih proven e meposhtme. Ky organi është i pa akredituar dhe atë i konstatuar si me poshte:



Abuzimi me prova shkresore dhe falsifikimi i dokumenteve gjithashtu shperfaqet ne rastin e poshte-prezantuar:

- Sipas sqarimit te ofruar kundrejte kerkeses se AK-se, për sqarim ne emer te z. Arben Murseli, është prezantuar certifikata me nr. 19100436 ku nga ta potencohet se WQR (World Quality Registrar) ka leshuar certifikate ne emer te te njejtit dhe potencohet se personi është certifikuar për trajnimin e mbetjeve (mbeturinave te rrezikshme).

- Për krahasim, ju prezantojme certifikaten e prezantuar OE i ri-rekomanduar nga AK – Komuna Peje.

CERTIFICATE

It is hereby certified that

Arben Murseli

ID Number: 07105364

Has successfully attended the training

Certified person for handling inert hazardous waste (s)

Person te certifikuar per trajtimin e mbetjeve (mbeturinave) te rrezikshme inerte

Held in Prishtina, Republic of Kosovo

Publication Date: 04.10.2019

Certificate Number: 19100436

WQR

World Quality Registrar

Director

The validity of the certificate can be checked through www.wqrcert.com

Ne si OE për te verifikuar te njejten, kemi kerkuar certifikimin sipas numër te certifikates 19100436, rezultati del se ky dokument është fiktiv dhe bartes i kesaj certifikate figuron tjetër person përkatësisht znj. Suzana Gjokutaj dhe jo Arben Murseli.



Ky është argumenti se grupi i OE-ve te ri-rekomanduar nga AK përveç tjerash edhe këtë dokument e ka falsifikuar, madje sipas nr. te certifikates rezulton qe kemi te bëjmë me certifikate te Suzana Gjokutaj e jo te z. Arben Murseli, te leshuar nga Institut i pa-akredituar. Rrjedhimisht kemi te bëjmë edhe me certifikim – fusheveprim krejt tjetër nga ai i prezantuar me sqarimet shtese.

AK – Komuna Peje, zyra e prokurimit, te gjitha këto prova dëshmi dhe fakte i mohon, i manipulon dhe nuk i raporton ashtu siç obligohet me dispozita ligjore dhe behet pjese e manipulimeve dhe me këto veprime inkriminohen edhe ne veprime penale siç është keqperdorimi ne prokurim publik dhe keqperdorimi i detyres dhe autoritetit zyrtat te sanksionuar me KPK.

Pretendimi ankimore 7:

AK – Komuna Peje, tendencen qellimin e caktuar dhe shkeljen e parimeve baze te prokurimit publik e ka shperfaqur për faktin se raporti i ri vlereimit te ofertave permban datën 25.01.2024, ndërsa kerkesa për sqarim te tenderit referuar grupit te OE- ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës permban datën 31.01.2024, perderisa pergjigja e dhënë nga OE te ri rekomanduar për dhënie te kontratës nuk permban date fare.

Ky fakt AK – Zyren e Prokurimit se bashku me anëtaret e komisionit vleresues te ofertave do

duhej ta bene përgjegjës per abuzues me dispozita ligjore.

Raporti i vlereimit te ofertave bazuar ne nenin 16 paragrafi 2 te RRPP-se nr. 001/2022. Regjistri permbledhes i prokurimit, parashef rrjedhen e procesit dhe veprimet te cilat duhet te ndermerren nga AK perkates, rrjedhimisht nuk mund qe fillimisht te nxjerrret raport rivleresues, pastaj te kerkohet sqarim shtese.

• Perfundimisht, bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara si me larte Grupi i OE-ve ankues, vlerëson se AK – Komuna Peje, edhe përgjatë ri vlerësimit te ofertave ka shkelur dispozitat ligjore, është inkriminuar ne vepra penale dhe nuk i ka raportuar, përkatësisht nuk i ka sqaruar dokumentet te cilat duket te jene fiktive dhe nuk është kerkuar konfirmim nga organi përmes te cilit supozohet se janë nxjerre te njejtat certifikime, prandaj grupi i OE-ve ankues, kerkon qe eksperti shqyrtues, bazuar ne dispozitat e nenit 113 dhe 114 te LPP-se, ti ndermerr te gjitha veprimet ligjore te konfirmoi vertetesin e dokumentacionit dhe t'i prezantoi te gjitha faktet dhe dëshmitë para panelit shqurtues ne atë mënyrë qe OSHP te nxjerre këtë:

U R D H E R E S E

- Te APROVOHET si e bazuar ne tërësi ankesa,

- Te Urdherohet AK – Komuna Peje, qe te kthej lender ne Rivleresim,

- Te shqiptohet GJOBE ndaj AK – Komuna Peje, ne kuptim te nenit 105, par 2.16, te LPP-se, për mos zbatim te vendimit me nr. 1032/2023.

Kompania jone është ne proces e sipër te hartimit, argumentimit dhe klasifikimit te provave dhe deshmive tjera, përmes te cilave vertetohet se është keqperdorur pozita dhe autoriteti zyrtar dhe është tentuar te realizohet mashtrimi ne prokurim publik, nga zyrtaret përgjegjës te AK – Komuna Peje.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Kërkesa 1** **Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik,gjat tre vite të fundit financiare duhet te jet jo më pak se 2.500.000.00 Euro. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1** **Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur**
		Kërkesa 2 Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme	**Dëshmia 2** **Dëshmia nga banka, jo më e vjetër se 6 muaj.**
		në llogari, ose akces në kredi, apo limit kreditor, në vlerë 300,000.00 euro.	**Dëshmia mund të mos jetë në emër të projektit por që e dëshmon se keni mjete të gatshme në bankë ose linjë kreditore (limit kreditor) të aprovuar në vlerën e kërkuar.**
	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 1** **Operatori ekonomik apo grupi i OE, duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për punë të ngjashme (ndertim i larte) në tri vitet e fundit nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontratë - në vlerën minimale prej 1,500,000.00 euro.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia 1** **Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) të natyres se ngjajshme ne tri vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë, të bashkangjitura me kopje te referencave apo certifikatave, raporteve te pranimeve në vlerën e kërkuar.**

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		**Kërkesa 2** **Lista e stafit profesional.** **2.1) Menaxheri i projektit - OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Konstruktiv, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.** **2.2) Menaxheri i punishtes - OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master ,Drejtimi Konstruktiv, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.** **2.3) OE duhet te deshmoj se ka nje inxhinjer te diplomuar te ndertimtarise, drejtimi konstruktiv. Kerkohet te kete min 5 vite pervoje pune - angazhim profesional.** **2.4) OE duhet te dëshmoj se**	**Dëshmia 2** **Dëshmia për kërkesën 2.1-2.2-2.3-2.4-2.5-2.6-2.7-2.8-2.9-2.10-2.11 -Stafin profesional.** **-Një pasqyrë tabelare të puntorëve dhe personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin, profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.** **Per stafin e kerkuar prezentuar duhet te dorezohen keto dokumente e deshmi** **-Kontratat valide kopje per stafin i cili gjendet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.** **-Parakontrate noteriale me vërtetim nënshkrimi te noteri ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, per stafin i cili nuk gjindet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.** **-Vendimi me shkrim për**

		ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Mbrojtje e Mjedisit, të jetë i çertifikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor të Republikës së Kosovës për Mbrojte të Mjedisit, , kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. **2.5) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Elektroteknikes, drejtimi Energjetike (jo bachelor), kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit.** **2.6) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Elektroteknikes, Drejtimi Elektronike. Kërkohet te ketë min. 5 vit përvojë pune –angazhime profesionale.**	**caktimin e menaxherit të projektit.** **-Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të punishtes.** **-Diploma e noterizuara. – çertifikata e noterizuara (per ata inxhinier që kerkohen).** **Sqarim: Ak mund të kërkoj për secilin dokument edhe dëshmi fizike.** **Aty ku thuhet pervoja e punes, gjithmon pervoja llogaritet per vitet pas diplomimit.** **Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës duhet diploma të jetë e nostifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.**

		2.7) OE duhet te deshmoj se ka nje Inxhinier te Arkitektures Kerkohet te kete min 5 vite pervoje pune ne fushen e projektimit. **2.8) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinjer apo master te diplomuar te Makinerise, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale.** **2.9) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Hidroteknikë, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit.** **2.10) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Gjeodezi, i liçencuar me licence valide, kërkohet te ketë min. 3 vite**	
		përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. **2.11) Një (1) Inxhinier i Emergjencave - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit.**	
		Kërkesa 3 **Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë.**	**Dëshmia 3 Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopja licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë.**

		Kërkesa 4 **Lista e stafit mbështetës të angazhuar në projekt; Një listë prej së paku Minimum 20 puntorë, minimum 10 puntorë duhet të jenë të çertifikuar për siguri në punë (për shkak të natyrës së rrezikshmërisë së punës).** **Minimum 1 person të çertifikuar për kranist (vinç).;** **Minimum 2 persona të çertifikuar për armim.;** **Minimum 1 person të çertifikuar për drenazhim të dheut dhe për trajtimin e mbetje të rrezikshme inerte.;** **Minimum 1 person të çertifikuar për kanalizim.;** **Minimum 1 person të çertifikuar për elektroinstalues.;** **Minimum 2 persona të çertifikuar për latues.;** **Minimum 1 persona të çertifikuar për saldues.;** **Minimum 1 person te çertifikuar/diplomuar per**	**Dëshmia 4 Lista e puntorëve e vulosur dhe nënshkruar. Kontratat e punës ose parakontrata në emër të projektit kopje. Kopja e çertifikatave diplomave për personat e çertifikuar.**

		punim me pllaka te keramikes dhe Granitit. **Minimum 1 persona të çertifikuar/diplomuar për kulme te rrafshta.** **Minimum 1 persona të çertifikuar per dhenjen e ndihmes se pare.** **Minimum 1 persona të çertifikuar per vedijesim per zjarrin dhe trajnimi per zjarrfikjen me aparate zjarrfikese.**	
	Kërkesa 5 **Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 1 te DT**	**Dëshmia 5 Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje të marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit, ndersa per ato mjete që nuk kanë libreza të qarkullimit Deklaratat unike doganore apo fatura. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.**	

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **AAG PROJEKT**

Fillimisht sqarojmë se, eksperti shqyrtues konform neni 113 dhe 114 të LPP-së, është i obliguar që ti shqyrtoj të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, duke konstatuar gjendjen, se si, secili pretendim mund ose duhet të trajtohet/korrigjohet tutje, duke rekomanduar panelin shqyrtues me rekomandim perfundimtar.

Tutje,

Pretendimi i parë i OE ankues:
Ekspertja shyqrtuese sqaron se, në rastin konkret, pretendimi lidhur me deklaratën dhe marreveshjen e konzorciumit të cilat nuk përkojnë me njëra tjetrën, sipas vlerësimit të ekspertes, sqarimi i tyre paraqet ndryshim material, për faktin se është kusht administrativ, andaj sipas mendimit të ekspertes kjo pike e kualifikon OE të rekomanduar si të papërgjegjshëm.

Konform nenit 59 par. 2 të LPP-së, citat:
"*2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi,*

vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues"

exp. nr. 1032/23:

> **Ekspertja Shqyrtuese** lidhur me pretendimin e tretë sqaron, në ofertën e GOE të rekomanduarit, në folderin 1.0, gjenden **marrëveshje bashkëpunimi**, në të cilën lidhet konzorciumi dhe tek neni 2 palët janë pajtuar që bartës i projektit të jetë partneri **"Dajting"SHPK**, i cili autorizohet që të firmosë të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën, gjerësa **tek deklarata** e bashkangjitur deklarohen se palët janë pajtuar që bartës i projektit të jetë partneri **"ATC COM"SHPK** i cili autorizohet që të firmosë të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën, si e tillë deklaratat nuk përkojnë me njëra tjetrën, përkundër që AK ka kërkuar sqarim dhe tutje OE i rekomanduar ka bashkangjitur në e-prokurim deklaratën e përmirësuar, mirëpo kjo deklaratë tani paraqet ndryshim material në ofertë, për faktin se ka përmirësime në dokument, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Në raportin e ekspertizës me nr.1032/23, kam rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim, si rrjedhojë AK është pajtuar plotësisht me rekomandimin, pa dhënë ndonjë koment shtesë, se nëse nuk pajtohet për ndonje pikë brënda pretendimeve, konform rregullores për prokurim publik nr.001/2022 neni 67 par. 3 dhe 4, dhe nenit 115 të LPP-së, gjerësa AK kthen lëndën në rivlerësim, duke ri rekomanduar të njëjtin OE.

Rrpp nr. 001/2022 neni 67.3 dhe 67.4:

"67.3 Nëse, në vendimin e tij, autoriteti kontraktues konstaton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme, dhe ankuesi nuk ka refuzuar, Autoriteti Kontraktues, brenda 5 ditëve ose kohës së lejuar nga eksperti, do të ndërmerr çfarëdo veprimi korrigjues të rekomanduar nga eksperti.
67.4 Nëse, brenda afatit kohor të specifikuar, autoriteti kontraktues nuk e nxjerr vendimin që e refuzon ose e mohon vlefshmërinë e një pretendimi ose që nuk e vlerëson farë vlefshmërinë e një pretendimi, ankesa do t'i referohet panelit shqyrtues. "

Pretendimi i dytë OE ankues:
Ekspertja shqyrtuese shpjegon se, në pretendimet ankimore ka dhënë përgjigje për secilin pretendim dhe menyrën se si mund te trajtohen të njejtat. Në ankesen 1032/23 disa pretendime kanë qenë të aprovuara si pjesërisht, duke sqaruar se si të njejtat munden të sqarohen.
Mirëpo, AK po që se sheh se operatori ekonomik nuk i permbush kërkesat e dosjes së tenderit përkatesisht kushtin administrativ, atëherë nuk ka nevojë që të vazhdoj tutje të sqarohet, për faktin se, AK është pajtuar plotësisht me raportin, si e tillë operatori ekonomik veçse kualifikohet si i papërgjegjshëm.

Pretendimi i tretë i OE ankues:
"Ngjashëm është vepruar edhe me menaxherin e punishtes ku është prezantuar z. Skender Loshi. Ne kontratën e lidhur me datën 03.01.2020, ne nenin 4, përcakton se orari i punës me punëdhënësin – anëtarin e grupit "ATC Com" shpk eshtë përcaktuar orari i punës prej 40 ore ne jave apo nga ora 08 deri ne 16. Sipas listës se Punëtoreve te ATK-se, te prezantuar ne oferte, z. Loshi, rezulton te ketë pune sekondare me anëtarin e grupit ATC Com shpk. Pra edhe

z. Loshi me punë primare është i deklaruar ne institucion tjetër ne cilësi te mësimdhënësit ne Shkolle te mesme dhe jo me anëtarin e grupit ATC Com shpk, prandaj edhe kontrata e prezantuar ne oferte e lidhur me z. Loshin do duhej te konsiderohej si fiktive dhe jo reale dhe si e tille krijon alibi, meçe është e pa mundur qe një person te jete i kontraktuar me pune primare ne dy vende pune apo ne dy lokacione te ndryshme"

Ekspertja shqyrtuese lidhur me listat e pagave, kemi sqaruar se, punëtorët kyq në menaxhimin e aktivitetit të prokurimit, pra dy menaxherët përkatësisht i projektit dhe i punishtës në lista figurojnë me **pune sekondare**, kurse kontratat jane te lidhura **me orar te plote 40 ore** ne jave, pra kontratat e lidhura të punes nuk përkojnë me listën e pagave, **andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Pretendimi i katërt i OE ankues:
Ekspertja shqyrtuese ka vlerësuar se sqarimi i deklaratave nën betim dhe marrëveshjes së konzorciumit paraqesin ndryshim material, per faktin se këto dokumente janë kusht administrativ dhe nuk mund të sqarohen apo te ndryshohen.
Pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Pretendimi i pestë i OE ankues:
Sa i perket pretendimit lidhur me punëtorin e certifikuar për kulme të rrafshta citat:
"*Madje sipas Agjencise Shqiptare te Punesimit – ASHP, përkatësisht bazuar ne ueb faqen e tyre (https://ashp.al/te-gjitha-kurset/), rezulton qe i njejti Agjencion fare nuk certifikon persona tille lidhur me hidroizolimet te ftohta dhe te ngrohta, përkatësisht kulme te rrafsheta. Rrjedhimisht, kjo certifikate eshte fiktive sipas uebfaqes dhe AK bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-se do duhej te kerkonte sqarim dhe ta eleminonte ofertën e tille."*

Ekspertja shyqrtuese pas analizimit në web faqe vëren se ky profesion nuk figuron, mirëpo ekspertja vlerëson se nuk është e nevojshme që ti shkruaj kompanisë, lidhur me certifikatën për verifikim, për arsye se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kushtin administrativ.

Pretendimi i gjashtë i OE ankues:

"Ngjashëm është vepruar edhe lidhur me inxhinierin z. Rrahman Safedini, ku ne shkresa te lendes nuk është prezantuar ndonjë reference për pune paraprakisht te realizuara, rrjedhimisht nuk e plotëson kërkesën dhe deshmine e përcaktuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ku ne piken 9.1 dhe 9.2 te FDT-se është kërkuar CV, reference, përkatësisht përvoja e punës sipas periudhës se përcaktuar"

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar nuk posedon dëshmi të eksperiencës, si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Tutje, pretendimi lidhur me certifikatën e punëtorit z. Arben Murseli, **pretendimi nuk gjendet i bazuar**, sepse sipas fakteve të prezantuara nga OE ankues, shohim se janë të pa akredituar, mirëpo AK në DT nuk ka specifikuar asgjë më shumë se të posedoj certifikatën. Kurse, sa i përket pretendimit lidhur me certifikatën për të cilën OE ankues pretendon se ka nderhyrje, ekspertja shqyrtuese nuk ka vazhduar me verifikim, për faktin se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kushtin administrativ.

Pretendimi tjetër i OE ankues citat:
"Ne ofertën e grupit te OE- ve te rekomanduar për dhënie te kontratës. z. Arben Murseli, është prezantuar ne cilësi te drejtorit te anëtarit "ATC Com" shpk, sipas certifikatës se ARBK-se, është nënshkruar deklarata nen Betim, ne emër te tije ne cilësi te Drejtorit te kompanisë, ndërsa tek lista e stafit mbështetës i njëjti është prezantuar ne cilësi te Personit te certifikuar për drenazhim te dheut dhe për trajtim te mbetjeve te rrezikshme inerte, është prezantuar si person i certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune ne cilësi te menaxherit, ndërsa sipas kontratës se datës 01.05.2021, se lidhur me vetveten rezulton qe z. Arben Murseli është i kontraktuar me OE "Atc Com" shpk, me kualifikimet si: Ekonomist, gjeodet, person i certifikuar për armim, drenazhim, mbrojtje inerte dhe menaxher i punishtes."

Ekspertja shqyrtuese sa i përket pretendimit, në raportin me nr 1032/23 ka sqaruar se këto pozita mund të kërkohen të sqarohen me njesinë kërkuese, kurse AK në rivlerësim nuk ka dëshmi që është konsultuar më njësinë kërkuese, mirpo sipas sqarimeve me lartë, konsideroj se nuk është e nevojshme për shkak se OE i rekomanduar nuk përmbushë kushtin administrativ.

Pretendimi i shtatë i OE ankues:

"*AK – Komuna Peje, tendencen qellimin e caktuar dhe shkeljen e parimeve baze te prokurimit publik e ka shperfaqur për faktin se raporti i ri vlereimit te ofertave permban datën 25.01.2024, ndërsa kerkesa për sqarim te tenderit referuar grupit te OE- ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës permban datën 31.01.2024, perderisa pergjigja e dhënë nga OE te ri rekomanduar për dhënie te kontratës nuk permban date fare*"

Ekspertja shqyrtuese pas analizmit dhe verifikimit te dokumenteve në e-prokurim sqaron se, raporti i rivlerësimit përmbanë datën 25.01.2024, në e-prokurim është e ngarkuar me datë 14.02.2024, kërkesa për sqarim nga AK përmbanë datën 31.01.2024, ndërsa përgjigjja e OE të rekomanduar është publikuar me datë 06.02.2024.

Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, ekspertja shqyrtuese vlerëson se, AK duhet ta kthej lëndën në rivlerësim, duke rekomanduar të njëjtën që procesin e rivlerësimit ta zhvilloj konform dispozitave ligjore të LPP-së, rregullores për prokurim publik nr. 001/2022 dhe udhëzuesit nr 001/2023 për prokurim publik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **AAG PROJEKT**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Blerina Huruglica